




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Ref: 1809/1017/KPM/mf**

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në kërkesën e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike Qeverisje Lokal dhe Media të datës 14 shtator 2018 në lidhje me mbrojtjen e sovranitetit të shtetit, në takimin e mbajtur me datën 18 shtator 2018, mori këtë:

**VENDIM**

**OBLIGOHET** operatori kabllor Artmotion që përkohësisht të bëjë ndërprerjen e transmetimit të të gjitha ngjarjeve sportive të UEFA Chamipons Leauge dhe UEFA Super Cup dhe UEFA Europa Leauge përmes kanalit Arena Sport deri në konstatimin përfundimtar që të drejtat e transmetimit të kompanive nga Republika e Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, të siguruara mbi bazën e tenderit të shpallur për territorin në Republikën e Serbisë nuk përbëjnë shkelje të kushtetutës si dhe nuk cenojnë sovranitetin e Republikës së Kosovës.


**ARSYETIM**

1. Me datën 5 shtator 2018, operatori Kabllor Kujtesa Net ka deponuar në KPM marrëveshje përmes të cilave ka siguruar të drejtat e transmetimit nga UEFA të UEFA Champions Leauge për territorin e Republikës së Kosovës në gjuhën Shqipe.
2. Me datën 13 shtator 2018, operatori tjetër Kabllor Artmotion për ngjarjet e njëjta ka deponuar marrëveshje përmes të cilave pretendon të ketë siguruar të drejtat e transmetimit për territorin e Kosovës përmes kanalit Arena Sport nga Telekom Serbia në gjuhën Serbe.
3. Marrëveshjet e deponuara nga të dy operatorët janë analizuar nga KPM me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe vërtetësisë të të drejtave të transmetimit. Bazuar në marrëveshjet e deponuara në KPM vërehet se operatori Kujtesa Net ka siguruar të drejtat për territorin e Kosovës direkt nga UEFA mbi baza ekskluzive në gjuhën Shqipe.
4. Bazuar në marrëveshjet e deponuara nga operatori Artmotion vërehet se të drejtat për transmetim janë siguruar nga operatorët serbe të cilët pretendojnë t'i kenë siguruar te drejtat e transmetimit nga UEFA edhe për territorin e Kosovës në gjuhën Serbe.
5. Në lidhje me këtë çështje Komisioni Parlamentar për Administratë Publike Qeverisje Lokal dhe Media, duke pas parasysh faktin se të drejtat e transmetimit në gjuhën Serbe për territorin e Kosovës janë siguruar mbi bazën e një tenderi të UEFA-së të shpallur për territorin e Republikës së Serbisë me çka edhe është cenuar sovraniteti i Republikës së Kosovës, ka kërkuar takim urgjent me Komisionin e Pavarur të Mediave.




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



6. Në këtë takim, të mbajtur me datën 14 shtator 2018, është kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave që të marr vendim përmes të cilit do të kërkohej nga operatori kabllor Artmotion që të ndërpres transmetimin e ngjarjeve sportive të siguruar nga Telekom Serbia deri në konstatimin përfundimtar që të drejtat e transmetimit të kompanive nga Republika e Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, të drejta këto të siguruar mbi bazën e tenderit të shpallur për territorin e Republikës së Serbisë nuk përbëjnë shkelje të kushtetutës dhe nuk cenojnë sovranitetin e Republikës së Kosovës.
7. Prandaj, duke u bazuar në kërkesën e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike Qeverisje Lokale dhe Media Komisioni i Pavarur i Mediave vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe ankesa kundër këtij vendimi nuk e pengon ekzekutimin e tij ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, pika 2.2 e Ligjit të KPM-së.

Muja FERATI

  
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



Data

18.09.2018